



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: fshmn@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

FSHMN

Ref. nr. 6144

Prishtinë, Dt. 27.10.2023

RAPORT I VLERËSIMIT TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMES
MASTER

FAKULTETI	FSHMN
Departamenti/ Programi	Biologjisë/ Msc. Biologji
Projektpropozimi	"Analizat algalogjike ne lumin Bistrica të fshatit Vranoc"
Kandidati	Alba Krasniqi
Mentori	Prof. Dr. Idriz Vehapi
Aprovimi i projekt propozimit në Këshillin e Fakultetit	Datë: 13.10.2023 Vendimi nr. 5722
Vlerësimi i dorëshkrimit Këshilli Shkencor i Fakultetit të Shkencave Matematiko Natyrore në mbledhjen e mbajtur me datën 13.10.2023 (vend. Nr. 5722) na ka caktuar anëtar të komisionit për vlerësimin e dorëshkrimit të temës së masterit të kandidates Alba Krasniqi, me titull: "Analizat algalogjike ne lumin Bistrica të fshatit Vranoc" Komisioni pas shqyrtimit të dorëshkrimit të punimit të temës së diplomës së masterit paraqet këtë RAPORT I. Shënimet e përgjithshme Punimi i temës së diplomës së masterit i kandidates Alba Krasniqi është shkruar në 45\ faqe, fondi i shkronjave 12, rrallori 1.5. Dorëshkrimi përmban: 4 figura, 12 fotografi nga puna në teren, 10 fotografi nga mikroskopi dhe 4 tabela. Janë cituar 39 burime të literaturës. Punimi i diplomës së masterit përbëhet nga këta kapituj: Hyrja (Faqe 5-8); Qëllimi i hulumtimit (Faqe 9-); Materiali dhe metodat (Faqe 10-17); Rezultatet e hulumtimit (18-32); Diskutimi (Faqe 33-34); Konkludime dhe rekomandime (Faqe 35); Përmbledhje (Faqe 36-	

37); **Summary** (Faqe 38-40); **Referencat** (Faqe 41-44); **Biografia** (Faqe 45).

II. Analiza e punimit

Në pjesën "Hyrja" autorja kryesisht është orientuar në citimin e punimeve nga literatura që kanë të bëjnë me lumenjtë dhe liqejtë më të rëndësishëm në Kosovë, të cilët janë jetikë për ujë të pijshëm, ujitje, industri etj. Në këtë aspekt autorja, posaçërisht, fokusohet në të dhënat e autoreve të huaj dhe vendorë në lidhje me biodiversitetin e algave në lumenjë dhe liqenjë dhe mundësinë e përdorimit të tyre në monitoringut biologjik si indikator të ndotjes.

Në kapitullin "Qëllimi i hulumtimit", kandidatja në këtë hulumtim tregon se qëllimi ka qenë studimi i diversitetit (përbërjes taksonomike) të algave në lumin Bistrica të fshatit Vranoc, i cili nuk është hulumtuar asnjëherë në këtë aspekt.

Me çrast janë hulumtuar: shumëllojeshmëria dhe shtrirja e algave në ekosisteme të lumit Bistrica në fshatin Vranoc; determinimi i llojeve të algave ujore të këtij lumi si dhe vlerësimi i diversitetit dhe shtrirjes së algave të pranishme në këtë ekosistem ujor.

Në kapitullin "Materiali dhe metodat" ceket se hulumtimet e algave ujore janë bërë në lumin Bistrica të fshatit Vranoc në komunën e Pejës i cili shtrihet në lartësi mbidetare 450 m me distancë prej 20 km. Ky lumë paraqet rrjedhën ujore të Lumbardhit të Deçanit, që është një degë e djathtë e lumit Drini i Bardhë, i gjatë 53 km. Kandidatja në mënyrë precize ka shtjelluar metodat e mostrimit, ato analitike (në hulumtime janë analizuar disa nga faktorët kryesor të cilët në mënyrë direkte apo indirekte ndikojnë në përhapjen e algave, e këta janë: TDS, saliniteti, konduktiviteti, temperatura dhe pH) dhe procedurat gjegjëse që punimin e kanë kompletuar.

Në Kapitullin "Rezultatet e hulumtimit" kandidatja në mënyrë precize shtjellon rezultatet e fituara të cilat janë paraqitur në mënyrë tabelare, ilustruar përmes figurave dhe fotografive.

Kur është fjala për rezultatet e fituara dhe komentin e tyre (komenti i rezultateve është bërë në kapitullin "Diskutimi", atëherë sipas autores mund të shpjegohen si vijon:

- Gjatë stinës dimërore, në bazë të dhënave të fituara gjatë hulumtimit të përbërjes algologjike të mostrave të marra në tri lokalitete, janë regjistruar 82 lloje të algave, të përfshira në gjashtë divizione: Cyanophyta, Bacillariophyta, Xanthophyta, Chlorophyta, Charophyta dhe Euglenophyta. Ndarja Bacillariophyta ka qenë më së shumti e pasur me lloje gjithësej (67 lloje).
- Gjatë sezonit veror, në bazë të dhënave të fituara gjatë hulumtimit të përbërjes algologjike të mostrave të marra në dy lokalitete, janë regjistruar 19 lloje algave ku prej

tyre u takojnë ndarjeve: Bacillariophyta me gjithësej (30 lloje), Cyanophyta (dy lloje), Chrysophyta (një lloj), Euglenophyta (një lloj), Charophyta (dy lloje).

- Në sezonën e dimrit algocenoza në lumin Bistrica të fshatit Vranoc ka qenë më e pasur me lloje se sa në sezonën e verës, për arsye se gjatë marrjes së mostrave në sezonën e dimrit sasia e të reshurave të shiut ka qenë më e ulët për dallim nga sezona e verës, në kohën kur janë marrë mostrat, sasia e të reshurave të shiut ka qenë shumë e lartë dhe ka ndikuar në shpejtimin e rrjedhës së ujit si dhe rritjen e sasisë së ujit, duke e zvogëluar kështu biodiversitetin e algave në këtë rajon.

Rezultate këto të cilat sipas kandidatës janë në harmoni me rezultatet e një numri të madh autorësh, vështruar nga literatura e viteve të fundit.

Në kapitullin “Konkludimet dhe rekomandimet” në bazë të hulumtimeve të bërë në lumin Bistrica të fshatit Vranoc, gjatë sezonit të dimërit dhe verës, kandidatja vjen deri në këto konkludime:

- Ka përcaktuar gjashtë divizione: *Cyanophyta*, *Bacillariophyta*, *Xanthophyta*, *Chlorophyta*, *Charophyta* dhe *Euglenophyta*.
- Numrin më të madhë të algave e ka determinuar gjatë sezonës së dimrit.
- Divizioni i *Bacillariophyta* ka dominuar në dy stinët dhe në të gjitha lokalitetet ku janë marrë mostrat ujore.
- Ndarja *Euglenophyta* është e përfaqësuar me vetëm një llojë gjatë sezonës së verës.

Kandidatja rekomandonë:

- Të punohet më shumë në lidhje me hartografinë algologjike të lumenjve të Kosovës, sidomos atyre që përshkojnë një territor të madh të vendit.
- Të analizohen në vazhdimësi mostra të ndryshme për të paraqitur në detaje gjendjen reale algologjike e cila siç e vërteton edhe ky punim mund të ndryshon dhe ka karakter dinamik për nga përbërja.
- Të i jepet rendësi të posaçme edhe ambientit për rreth e sidomos ndotjes e cila ndikon edhe në përbërjen algologjike të ujërave si dhe

- Të vazhdohen hulumtime të mëtejme në këtë fushë studimi.

III. Vlerësimi dhe propozimi




Punimi i temës së diplomës së masterit i kandidatës **Alba Krasniqi** është punim shkencor burimor, është interesante si nga aspekti fundamental shkencor (studimi i diversitetit të algave në lumin Bistrica të fshatit Vranoc, i cili nuk është hulumtuar asnjëherë në këtë aspekt) ashtu edhe nga aspekti aplikativ (biomonitorimi i ndotjes së lumenjeve).

Hulumtimet janë përcjellur në mënyrë korrekte. Metodologjia e përdorur është mjaft aktuale, ndërsa rezultatet e fituara japin përgjigje në qëllimin dhe detyrat e hulumtimit. Ato, njëherit ndriçojnë disa tema të hapura në ekotoksikologji, veçanërisht sa i përket efekteve të ndotjes në biodiversitetin e algave .

Në bazë të asaj që u cek më lartë, Komisioni e vlerëson me notë të lartë punimin e temës së diplomës së masterit të kandidatës **Alba Krasniqi**, me titull: “**Analizat algalogjike ne lumin Bistrica të fshatit Vranoc**” dhe i propozon Këshillit Shkencor-Mësimor të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore në Prishtinë që punimin në fjalë t`a pranoj dhe t`ia mundësoj kandidatës mbrojtjen publike më qëllim të fitimit të titullit: Master i shkencave të biologjisë.

Prishtinë, 27.10.2023

Komisioni:

1. 
/Prof. Dr. Kasum Letaj – kryetar/
2. 
/ Prof. Dr. Idriz Vehapi – anëtar
(mentor)
3. 
/ Prof. Dr. Elez Krasniqi – anëtar/